



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. Protokolit: 060/01-74404

Data: 09.09.2024

Për: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF

FTESË

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e VIII të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Mbledhja do të mbahet me dt. 16.09.2024 (Hëne), ora: 11:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vërejtje: Komiteti për Politikë dhe Financa mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesat.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 16.07.2024.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2025-2027.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtarëve të KKSB-së për vitin 2023 dhe 2024.
9. Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
10. Shqyrtimi dhe rekomandimi për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

12. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të DÇPJ dhe Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
13. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar. *(Për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Premte, me dt.13.09.2024).*

KRYESUESI I KPF-së
z. Rexhep Kurtbogaj